

Pranuar më: Primljeno:	28.09	2021
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
A-400-	58552	

## MARRËVESHJE E PARTNERITETIT

### NDËRMJET

### PROJEKTIT PËR KOMUNA TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE- DAI GLOBAL LLC

DHE

### KOMUNËS SË LIPJANIT

DHE

### PROTEC SHPK

- I. Përderisa, DAI Global LLC, që operon përmes entitetit të vet lokal, Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse - DAI GLOBAL LLC, duke zbatuar Projektin Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM), mbështet komunën e LIPJANIT ("Komuna"), duke blerë bashkërisht mallra dhe shërbime ndërtimi nga PROTEC Sh.P.K. ("Shitësi"), që gjendet në Prizren, Kosovë; së bashku të identifikuar më tutje si "Palët";
- II. Informata të përgjithshme dhe kontributet në prokurim


Aktiviteti i USAID-it Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse është projekt pesëvjeçar i financuar nga Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar, i cili filloi më 11 Janar 2017 dhe është planifikuar të përfundojë në Janar 2022. Projekti është dizajnuar për të promovuar barazinë, transparencën dhe mbikëqyrjen në prokurim, duke ofruar ndihmë të gjithanshme në 38 komunat e Kosovës, me theks të posaçëm tek pesë komuna të fokusimit, me anë të mentorimit, trajnimit dhe udhëzimit për të përmirësuar llogaridhënien për fonde e shpenzime publike.

Komuna nuk do të pranoj asnjë kontribut monetar të ndërlidhur me këtë Grant. Në bazë të këtij asistence të administruar nga Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse-DAI Global LLC, Agjencia e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar do të sigurojë bashkërisht mallra dhe shërbime komunës së Lipjanit, mbështetje në "Blerjen e Arkivave metalike dhe Inventarit" ("Projekti") duke blerë bashkërisht mallra dhe shërbime nga PROTEC SHPK. përmes një Nënkontrate. Kostoja totale e projektit është **17,891.74 EUR**. Kontributi i projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse i USAID-it për projektin, në shumë prej **16,366.00 EUR** nuk i nënshtrohet Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe është për prokurimin e mallrave ose shërbimeve të specifikuara në Shtojcën A-Seksioni I. Kontributi i komunës, në shumë prej **1,293.00 EUR**, është për prokurimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të specifikuara në Shtojcën A-Seksioni II, dhe i nënshtrohen TVSH-së në shumë prej **232.74 EUR**, që e ngre totalin e kontributit të komunës në **1,525.74 EUR**. Komuna do t'ia paguaj kontributin e vet dhe TVSH-në e ndërlidhur drejtpërsëdrejti Shitësit.

Ky grant për Komunën e Lipjanit i nënshtrohet termeve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje të partneritetit dhe është në fuqi nga data e nënshkrimit nga zyrtarët e autorizuar të Palëve. Blerja e mallrave dhe/ose shërbimeve nga Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse-DAI Global LLC do të menaxhohet nga Nënkontrata ose Urdhër-blerja që do të miratohet ndërmjet Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse-DAI Global LLC dhe Shitësi.

2. Palët e kësaj Marrëveshjeje të partneritetit zotohen që të punojnë së bashku që të arrijnë një shkallë të lartë të bashkëpunimit dhe të suksesit gjatë zbatimit të projektit. Palët zotohen që të zgjidhin përmes marrëveshjeve të ndërsjella, nëse ndonjë çështje nuk zgjidhet me marrëveshje të përbashkët, palët bien dakord për ndërmjetësim në pajtim me Rregullat e Qendrës Alternativë për Zgjidhjen e Kontesteve në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë.
3. Kjo Marrëveshje e partneritetit ekzekutohet në tri (3) kopje origjinale; një (3) në gjuhën angleze dhe një (3) në gjuhën shqipe. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.
4. Kjo Marrëveshje e partneritetit do të jetë në fuqi deri në përfundimin e Certifikatës/Aktit të pranimit ose marrëveshjes së ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Dakorduar nga palët më 15.Shtator 2021.

  
Imri Ahmeti  
Kryetari i komunës  
Komuna Lipjan

  
Aferdita Mekuli  
Drejtori i projektit  
TEAM-DAI Global LLC

  
Genc Hoxha  
Drejtori  
PROTEC SHPK

